LIGJ
Nr. 73/2016

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR. 9232, DATË 13.5.2004, "PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 39/1 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) Në pikën 5 hiqet togfjalëshi "Ujëmbledhësi i Bovillës".

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1. Për objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, kalimi i së drejtës së pronësisë mbi objektin dhe truallin realizohet pa pagesë nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, procedurat dhe afatet që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9708, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani